



Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST

**ARRITJET
NË 2 VJET**

#DUAPARTNERINVEST #2VJET




Nga ideja në realitet, udhëtimi i **Dua Partner Invest** ka qenë një histori rritjeje dhe suksesi në vetëm 2 vjet!

Jemi shumë krenarë për gjithçka që kemi arritur në një kohë kaq të shkurtër, nga krijimi i platformës deri te sjellja së bashku e qindra anëtarëve nga Ballkani Perëndimor dhe jo vetëm.

Dëshirojmë t'ju falënderojmë të gjithëve që u bashkuat me ne në këtë udhëtim të jashtëzakonshëm, dhe të ndajmë me ju arritjet kryesore të platformës në 2 vjet.



TABLA E PËRMBAJTJES



RRETH Dua Partner Invest

MISIONI & VIZIONI I Dua Partner Invest

KOMUNITETI I Dua Partner Invest

LANÇIMI I Dua Partner Invest

PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET E Dua Partner Invest

SHËRBIMET PËR ANËTARËT DHE PËRFITUESIT E Dua Partner Invest

SKEMA MBËSHTETËSE TË PREZANTUARA PËRMES Dua Partner Invest

BASHKËPUNIMI, PJESËMARRJA DHE PREZANTIMI I Dua Partner Invest **NË**
EVENTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

LAJME & NJOFTIME NGA Dua Partner Invest **MBI ZHVILLIMET E FUNDIT NË**
FUSHËN E SIPËRMARRJES

PUBLIKIME & PROMOVIME NË Dua Partner Invest

RRJETET SOCIALE TË Dua Partner Invest

ÇFARË PRITET NË VIJIM NGA Dua Partner Invest



RRETH

Dua Partner Invest



Kyçu në llogari

Regjistrohu

Shqip

Për Sipërmarrësit

Për Investitorët

Për Konsulentët

Rreth Nesh

Lajmet & Eventet

Libraria

Pyetje të Shpeshta



Aksesimi i fondeve
dhe ekspertizës
renditen si një nga
barrierat më të
mëdha për startupet
në rajon sot.

Ne të ndihmojmë të tejkalosh këtë barrierë



DUA PARTNER INVEST **ARRITJET NË 2 VJET**
#DUAPARTNERINVEST #2VJET



Dua Partner Invest

Powered by



Dua Partner Invest (DPI) është një platformë bashkëpunuese në fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit, e lançuar nga **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim** (PSh), në vitin 2021. DPI është një qendër virtuale dhe vjen si një mundësi për zhvillimin e startup-eve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke ofruar një paketë të plotë shërbimesh si: mundësi për financim fillestar, mentorim, ekspozim tregu, partneritete ndërkombëtare dhe promovim.

Dua Partner Invest mbështet ekosistemin e sipërmarrjes dhe sjell së bashku tre aktorë kryesorë: **startup-e** që kërkojnë mundësi financimi, **investitorë** ndërkombëtarë (kompani, fonde të kapitalit sipërmarrës, donatorë, skema investimi me impakt) që kërkojnë ide biznesi konkurruese, dhe **konsulentë** me ekspertizë të ndryshme në sektorin e startup-eve, duke ofruar kështu një mundësi unike për zhvillimin e startup-eve që sjellin impakt social dhe mjedisor.



DUA PARTNER INVEST **ARRITJET NË 2 VJET**
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

MISIONI & VIZIONI I

Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

VIZIONI I DPI

Dua Partner Invest ndihmon në tejkalimin me sukses të barrierave të aksesit në financa duke qenë një vend takimi midis të rinjve premtues që përballen me sfidën e vazhdueshme për të gjetur mbështetje për të sjellë në praktikë idetë e tyre, dhe investitorëve me përvojë që kërkojnë suksesin e ardhshëm.

MISIONI I DPI

- ▶ Zhvillimi i ekosistemit të sipërmarrjes dhe inovacionit social
- ▶ Lehtësimi i komunikimit dhe ndërveprimit të aktorëve të ekosistemit
- ▶ Përfitimi nga mundësitë e përbashkëta




KOMUNITETI I

Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

Komuniteti i DPI është rritur në mënyrë të vazhdueshme përgjatë dy viteve dhe vazhdon të rritet çdo ditë! Jemi shumë të lumtur që mbështesim komunitetin tonë në sukseset e tyre!



LANÇIMI I

Dua Partner Invest

REGIONAL EVENT

A CLICK AWAY FROM ENTREPRENEURSHIP!

October 20, 2021 | 10:00-12:00 CET
ONLINE



Scan link
to register




Dua Partner Invest

Powered by



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET



Dua Partner Invest u lançua zyrtarisht nga Partnerët Shqipëri në tetor të vitit 2021, në eventin rajonal “Një Klikim Larg Sipërmarrjes!”. Aktiviteti mbledhi së bashku 70 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit të sipërmarrjes sociale nga 6 vende të Ballkanit Perëndimor, të cilët patën mundësinë të dëgjojnë mbi mundësitë dhe mekanizmat mbështetës të Komisionit Evropian të paraqitur nga DG GROW dhe përfaqësues të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Ndërkohë përfaqësues të qeverive dhe organizatave mbështetëse në fushën e sipërmarrjes, nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ofruan një pasqyrë të programeve dhe instrumenteve në mbështetje të ekosistemit të start-up-eve dhe sipërmarrjes.

Dua Partner Invest u prezantua për pjesëmarrësit si një platformë rajonale, një qendër virtuale që i shërben komunitetit të startup-eve në rajon, dhe i ftoi pjesëmarrësit të bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe mbështetur më tej sektorin e sipërmarrjes në rajon.



PARTNERITETET & BASHKËPUNIMET E Dua Partner Invest



Dua Partner Invest

Powered by



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET



DUA PARTNER INVEST UNIVERSITETI METROPOLITAN DHE QENDRA METRORESEARCH



6 AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA

Marrëveshja me [Universitetin Metropolitan](#) dhe [Qendrën MetroResearch](#), ka në fokus bashkëpunimin për zhvillimin e sipërmarrjes sociale dhe startup-eve përmes kërkimit shkencor dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë organizuar **2 sesione trajnimi** online për anëtarët e platformës DPI nga ekspertë të Universitetit Metropolitan, **1 trajnim online** nga ekspertët e PSh për studentët e universitetit dhe **3 takime** në Universitetin Metropolitan për të prezantuar para studentëve platformën DPI, duke u ofruar atyre mundësinë për t'u regjistruar në platformë dhe për të përfituar nga avantazhet e regjistrimit si antarë në DPI.

DUA PARTNER INVEST QENDRA YUNUS PËR BIZNESIN SOCIAL DHE QËNDRUESHMËRINË

Platforma Dua Partner Invest bashkëpunon me [Yunus Center for Social Business and Sustainability \(YCSBS\)](#) – Qendra Yunus për Biznesin Social dhe Qëndrueshmërinë. Në këtë partneritet YCSBS ka kontribuar duke prezantuar platformën te studentët e [Universitetit Epoka](#) si dhe duke ofruar shërbime të konsulencës.

Ndërsa Dua Partner Invest ka ofruar mundësi për aplikime, trajnime dhe mbështetje për studentët, anëtarë të mundshëm të platformës.





DUA PARTNER INVEST FIL ROUGE CAPITAL



FIL
ROUGE
CAPITAL

Dua Partner Invest ka krijuar partneritet ekskluziv me Fil Rouge Capital, një kompani private investimesh që investon në biznese në fazat e hershme. Fil Rouge Capital përfaqëson një mundësi unike që u ofron të gjithë sipërmarrësve në Ballkanin Perëndimor, akses në investime, zhvillim, rritje dhe ndryshime me ritmin e zhvillimit të inovacionit.

Nëpërmjet këtij partneriteti DPI ka organizuar një **takim online** me anëtarët e platformës dhe Fil Rouge Capital, ku ata prezantuan programin e tyre përshpejtues dhe mundësitë e ofruara me një avantazh për anëtarët e DPI. Në këtë takim antarët e DPI patën mundësinë të prezantonin idetë e tyre potenciale sipërmarrëse, me qëllim vlerësimin e mundësive për bashkëpunim në të ardhmen.

Në vijim të bashkëpunimit me Fil Rouge Capital, **5 sipërmarrës të rinj**, anëtarë të platformës DPI, që operojnë në fushën e teknologjisë dhe digjitalizimit, u përzgjedhën dhe u ftuan të regjistroheshin dhe të merrnin pjesë në programin e përshpejtimit të Fil Rouge Capital, duke hapur në këtë mënyrë rrugën për mundësi të mëtejshme për mbështetje dhe financim.

DUA PARTNER INVEST TRAVELIFE

Dua Partner Invest ka lidhur partneritet me [Travelife për Operatorët Turistikë](#), një program ndërkombëtar lider për trajnim, menaxhim dhe certifikim në lidhje me qëndrueshmërinë në turizëm. Ky partneritet synon që të mbështesë dhe t'ju vijë në ndihmë operatoreve turistikë për kalimin e tyre drejt një biznesi të qëndrueshëm në sektorin e turizmit. Nëpërmjet këtij partneriteti, anëtarët e DPI që janë operatorë turistikë mund të përfitojnë **50% zbritje** në tarifën e anëtarësisë në Travelife për vitin e parë. Ata gjithashtu kanë mundësinë të aplikojnë në programin 'SUSTOURM SME' dhe të përfitojnë **anëtarësim falas në Travelife** deri në fund të vitit 2023.

Dua Partner Invest ka organizuar **3 seanca online** me të gjithë subjektet e interesuara, për t'u njohur me shërbimet që ofron Travelife, procesin e certifikimit, rastet e suksesit dhe informacionin e nevojshëm për të kontribuar drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.



Dua Partner Invest

Powered by
PARTNERS ALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT



Travelife 
Sustainability in tourism



DUA PARTNER INVEST NOW SPRINT ACCELERATOR

Dua Partner Invest bashkëpunon ngushtë me [Now Sprint Accelerator](#). Ky bashkëpunim ka qenë shumë i vlefshëm, pasi DPI ka shpërndarë për anëtarët e tij në platformë dhe për të gjithë komunitetin që ndjek DPI në mediat sociale, programin e përshpejtimit të Now Sprint Accelerator për startupe në fazat e hershme, duke mundësuar një shtrirje të gjerë të thirrjes në Rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP). Në përfundim të njërit prej programeve të përshpejtimit, **2 ekipe nga BP** arritën në finalen e programit Now Sprint Accelerator, Immortelle Shpk – Shqipëri dhe Little Explorers – Republika e Maqedonisë së Veriut.



DUA PARTNER INVEST PJESË E DATABAZËS SË "THE POSSIBILISTS"

the
Possibilists

Dua Partner Invest (DPI) Platform



Dua Partner Invest është pjesë e databazës së "The Possibilists", e cila operon në rang global dhe ka në fokus ofrimin e granteve, ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen për inovatorët e rinj. "The Possibilists" është një aleancë e përkushtuar në ofrimin e të dhënave reale për jetën dhe punën e inovatorëve të rinj si dhe për përmirësimin e kushteve të jetës së tyre. Nëpërmjet këtij anëtarësimi, platforma DPI ofron kontributin e saj në ekosistemin e "The Possibilists", dhe sjell mundësi të reja për antarët e saj.



VALBONA GURI

**CREDINS BANK
INVESTITOR DHE KONSULENT**



Credins Bank ofron mbështetje financiare dhe konsulencë pro-bono për shumë startup-e, duke i konsideruar ato një aset të madh për vendin. Dua Partner Invest përmes mbështetjes së Partnerëve Shqipëri do të jetë një shtysë për zhvillimin e startup-eve në Ballkanin Përndimor.



JULIEN COUSTAURY

**FIL ROGUE CAPITAL
INVESTITOR**



Ne jemi shumë të kënaqur që jemi partnerë me Dua Partner Invest, pasi platforma na ofron mundësinë për të identifikuar dhe bashkëpunuar me ekosistemin e startup-eve në Shqipëri, duke i shërbyer kështu misionit tonë për të zhvilluar skenën e startup-eve në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.





ORNELA BEGO

**ONE ALBANIA
INVESTITOR**




ONE Albania beson te zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Ne gjejmë te Dua Partner Invest të njëjtat vlera, prandaj besojmë që kjo platformë do të kthehet në një pikë referimi për ekosistemin e startup-eve.



SHËRBIMET PËR ANTARËT DHE PËRFITUESIT E

Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

• EVENTET KRYESORE

Evente të organizuara nga platforma DPI, për anëtarët e saj:

1

Event Rajonal

"Një Klikim Larg Sipërmarrjes" Lançimi i
Platformës Dua Partner Invest

3

Sesione Online

Për operatorët turistikë si pjesë e
partneritetit të DPI me Travelife

3

Trajnime

Për komunitetin e startup-eve të ofruara
nga konsulentët e regjistruar në platformë

1

Takim me Aëntarët e DPI

Takim i anëtareve të DPI me investitorin
dhe anëtarin e DPI, Fil Rogue Capital

1

Takim dhe Prezantim i anëtarit të ri të
DPI "Kultura List"



• TRAJNIME MBI SIPËRMARRJEN

6

Trajnime Online

Për aplikantët e Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta

3

Trajnime Online

Drejtuar anëtarëve të DPI dhe komunitetit të startup-eve, nga ekspertë ndërkombëtarë dhe konsulentë të Dua Partner Invest

• SESIONE INFORMUESE

16

Sesione Informuese

3 online dhe 13 në prezencë, për të prezantuar te aplikantët e interesuar platformën Dua Partner Invest, funksionet e saj dhe hapat që duhen ndjekur për t'u regjistruar dhe për t'u bërë pjesë e komunitetit sipërmarrës, për të përfituar nga mundësitë që platforma ofron.






BLERINA ZYBERI

THESARET E SHIJEVE TË PËRMETIT
SIPËRMARRËSE



Thesaret e Shijeve të Përmetit mori jetë falë aplikimit në Dua Partner Invest përmes mbështetjes financiare dhe konsulencës së Partnerëve Shqipëri. Falë aktiviteteve dhe promovimit, kam përfituar nga nxitja e interesit, shitjet dhe krijimi i besnikërisë përmes rritjes së trafikut të klientëve.





XHENSON ÇELA

ROMIX COMMUNITY COMICS AND TOYS
SIPËRMARRËS



“Romix Community Comics & Toys” është simbol i një simbioze midis edukimit dhe argëtimit, qëllimi i të cilit shtrihet deri në objektivat sociale, duke besuar që kontribuon në të gjithë ekosistemin. Ndiem me fat që jam pjesë e DPI, ku aktorët gjejnë mbështetje dhe zhvillohen së bashku.



SKEMAT MBËSHTETËSE TË PREZANTUARA PËRMES Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

20


SIPËRMARRËS TË REGJISTRUAR NË PLATFORMË PËRFITUAN MBËSHTETJE FINANCIARE DHE

248

SIPËRMARRËS PËRFITUAN NGA TRAJNIMET E PREZANTUARA NGA DPI DHE TË ORFUARA NGA PSH



NË KUADËR TË PROJEKTEVE TË ZBATUARA NGA PSH DHE TË PROMOVUARA NGA DPI



WISEs4Youth



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

BASHKËPUNIMET, PJESËMARRJA DHE PREZANTIMI I Dua Partner Invest NË EVENTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

PANAIRE & EKSPOZITA



PANAIRI NDËRKOMBËTAR I TIRANËS

Dua Partner Invest së bashku me 10 anëtarë të platformës, sipërmarrje të mbështetura nga PSh ndër vite, mori pjesë dhe promovoi shërbimet e saj në **Panairin Ndërkombëtar të Tiranës** të organizuar nga KLIK Ekspo Group. Pjesëmarrja në panair solli shumë përfitime dhe u vlerësua si një mundësi e artë nga të gjithë sipërmarrësit për të rritur vizibilitetin, për të vendosur kontakte përmes takimeve B2B dhe për të shitur produktet e tyre.

PANAIRI I PUNËS

Dua Partner Invest iu prezantua studentëve gjatë **Panairit të Punës** të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës. Studentët u informuan në lidhje me procesin e regjistrimit, mundësitë dhe aktivitetet e organizuara nga platforma.

PANAIRI DHE KONKURSI KOMBËTAR I KOMPANIVE TË NXËNËSVE

Ekipi i DPI mori pjesë në **Konkursin Kombëtar të Kompanive të Nxënësve 2022**, organizuar nga Junior Achievement of Albania, ku mësuan më shumë rreth ideve të biznesit të studentëve, start-up-eve, kompanive, dhe prezantuan platformën DPI si një mundësi për sipërmarrësit e rinj për të përfituar nga shërbimet që ofron DPI.

EKSPOZITA PËR KLIMËN

Në aktivitetin **“Ekspozita për Klimën”**, organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, PSh prezantoi te studentët platformën Dua Partner Invest dhe programet e saj në mbështetje të ekonomisë së gjelbërt dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe Konkursin e Bizneseve të Gjelbërta si një mundësi për studentët për të aplikuar nëpërmjet platformës me idetë e tyre të biznesit.



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

TAKIME ME AKTORËT E EKOSISTEMIT



Ekipi i Dua Partner Invest dhe PSh mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes gjatë Javës Globale të Sipërmarrjes 2021. Në takim u diskutua për ecurinë e përgatitjes së projektligjit për start-up-et dhe për aktivitetet e aktorëve të ekosistemit në fushën e sipërmarrjes dhe mënyrën se si ata mund të ndërveprojnë me ministren për të krijuar vlera.

FORUMI I INOVACIONIT DHE BIZNESIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR (BUTTERFLY)



Dua Partner Invest u prezantua në **Forumin e Inovacionit dhe Biznesit në Ballkanin Perëndimor**, në panelin mbi Inovacionin Social, si një hub që mbështet dhe kontribuon në zhvillimin e sipërmarrjes sociale dhe inovacionit në rajon.

FORUMI RAJONAL RISE

Kontributi i Dua Partner Invest u soll në vëmendje edhe gjatë sesionit "Bang the Drum for Social Economy in WB6" në **Forumin Rajonal RISE** në Tiranë. Platforma DPI prezantoi gamën e saj të larmishme të shërbimeve, skemat mbështetëse dhe ndau me të pranishmit eksperiencën e anëtarëve të saj gjatë përdorimit të platformës. Në takim u inkurajua pjesëmarrja rajonale brenda platformës dhe angazhimi dhe bashkëpunimi aktiv ndërmjet palëve të interesuara.



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET



ALBA SKENDAJ

KONSULENTE



Bashkëpunimi me platformën DPI ka qenë dhe është unik për karrierën time profesionale, ku kam 'fituar' një aleat të besueshëm për një sukses afatgjatë e të qëndrueshëm. Ia rekomandoj kujt do që beson në artin e mentorimit dhe dëshiron të zgjerojë një rrjet të rëndësishëm bashkëpunorësh.




ALDA DHAMO

KONSULENTE



Jam e kënaqur që jam njohur me platformën Dua Partner Invest, e cila mundëson përputhjen e aftësive me shërbimet, të tilla si mentorim dhe konsulencë. Kam pasur mundësinë të ofroj mentorim dhe mbështetje për 3 biznese, pjesë e Konkursit të Bizneseve të Gjellbërta, e t'i shoh ata të përmirësojnë aftësitë.



LAJME & NJOFTIME NGA

Dua Partner Invest

MBI ZHVILLIMET E FUNDIT NË FUSHËN E SIPËRMARRJES



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

3

Përditësime/Lajme mbi Zhvillimet e Fundit në **Legjislacionin Shqiptar të Startup-eve dhe Sipërmarrjeve Sociale**

1

Përditësim/Lajm mbi Zhvillimet në **Legjislacionin e Sipërmarrjeve Sociale në Rajon**

3

Përditësime mbi Zhvillimet e Fundit në **Fushën e Sipërmarrjes në Rajon**

2

Përditësime mbi **Zhvillimin e Ekonomisë Sociale në Evropë**

2

Përditësime mbi **Mekanizmat Financiarë për Startup-et dhe Përshejtuesit** të ofruar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në Shqipëri

2

Përditësime mbi **Mekanizmat Financiarë Ekzistues në Rajon**


3

Pjesëmarrje në Aktivitete mbi **Ekonominë Sociale në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë**



92

Lajme të publikuara
në platformën DPI



8

Njoftime mbi
Partneritet



10

Mundësi të ofurura
nga Përrshpejtuesit



32

Mundësi
Financiare



18

Mundësi
Trajnimi



7

Takime
Online



5

Oferta për
Anëtarët



12

Mundësi të
Tjera



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

PUBLIKIME & PROMOVIME NË

Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

19

PUBLIKIME PËR
EKOSISTEMIN E
SIPËRMARRJES

7

BULETINE INFORMUESE DREJTUAR
1000 KONTAKTEVE KOMBËTARE
DHE NDËRKOMBËTARE

10

DËSHMI NGA ANËTARËT E
PLATFORMËS RRETH EKSPERIENCËS SË
TYRE NË DUA PARTNER INVEST

16


VIDEO TË ANËTARËRVE TË DPI JANË
PËRGATITUR NGA PSH DHE JANË
PROMOVUAR NËPËRMJET DUA
PARTNER INVEST



DUA PARTNER INVEST **ARRITJET NË 2 VJET**
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

RRJETET SOCIALE TË

DUA PARTNER INVEST



DUA PARTNER INVEST **ARRITJET NË 2 VJET**
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

FACEBOOK



Ndjekës

823



POSTIME



370



AUDIENCA E ARRITUR

58 487

AUDIENCA



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

INSTAGRAM



Ndjekës

735



POSTIME



339



AUDIENCA E ARRITUR

8 491

AUDIENCA



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

ÇFARË PRITET NË VIJIM NGA DUA PARTNER INVEST



ZGJERIM DHE RRRITJE

Dua Partner Invest synon të zgjerojë praninë dhe rrjetin e saj brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet partneriteteve dhe bashkëpunimeve strategjike.



PËRMIRËSIM I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Platforma do të vazhdojë të ofrojë dhe të përmirësojë më tej shërbimet e saj, duke përfshirë mundësi financimi, programe mentorimi, ekspozim në treg, partneritete ndërkombëtare dhe promovim.



RRITJE TË ANGAZHIMIT TË INVESTITORËVE

Dua Partner Invest do të kultivojë në mënyrë aktive marrëdhëniet me investitorët ndërkombëtarë për të ofruar mundësi dhe konkurse për ide biznesi dhe për të siguruar financimin e nevojshëm.



EDUKIMI DHE SHKËMBIMI I NJOHURIVE

Workshop-et, webinar-ët dhe eventet e rrjetëzimit do të lehtësojnë shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira midis startup-eve, investitorëve dhe konsulentëve.



MATJA E IMPAKTIT DHE SUKSESIT

Platforma është e përkushtuar të monitorojë dhe vlerësojë impaktin e saj në ekosistemin e sipërmarrjes, dhe të hartojë strategji të ardhshme për zhvillim dhe përmirësim.



BASHKOHUNI NË KOMUNITETIN TONË!



Dua Partner Invest



DUA PARTNER INVEST ARRITJET NË 2 VJET
#DUAPARTNERINVEST #2VJET

KONTAKTE



Website

<https://duapartnerinvest.com/>



Adresa e e-mailit

info@duapartnerinvest.com



Telefon

+ 355 42254881

RRJETET SOCIALE

